3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Vlerësimit;
  - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  - 6. Preventivin e çmimeve
  - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula**



**Shënim:**Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/ Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE****Bashkelidhur DST-VE**

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:**

**Bashkelidhur DST-VE**

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, 230 049.95 (dyqind e tridhjetë mijë e dyzet e nëntë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2018, 2019 dhe 2020 të leshuara nga administrata tatimore, të konfirmuara nga Administrata Tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

Ku të pakëtu në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga Administrata Tatimore të 3 viteve të fundit 2018, 2019, 2020, ku vlera të mos jetë më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, të leshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore, ku operatori ekonomik ka selinë.

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formulari përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, është të paktën sa dyfishi i vlerës së fondit limit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvjes së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklarat sipas shtojcës nr. 8 shoqëruar me :

- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Aktin e marrjes në dorezim

Vertetimi realizimi (ku shenohen vlera, afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së realizuar)

Në rastin e përvjes së mëparshme me sektorin privat kërkohen të paraqiten:

- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Faturë tatimore ku shenohen datat, vlerat

Pika 1/a plotësohet nga antari I cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Antaret e tjera të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë operatorët anëtarë të bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

### **2.3.2 Liçenca profesionale , lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për kategoritë e mëposhtme.**

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçencat e mëposhtme:**

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë
- NP-2 A Ndërtime civile dhe industriale
- NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.

**Për punimet special të ndërtimit duhet të ketë liçencat e mëposhtme**

- NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe lidhura me to, rifiniturë me materjale druri, plastike, metalike dhe xhami , rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- NS-14 A Impiante të brendshme , elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.
- NS-18 A Punime topogjeodezike.

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e liçencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

### **2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë liçencat e mëposhtme:**

- Licencën II.4 për prodhimin dhe tregëtimin e farërave dhe fidanëve për shërbimin e gjelbërimit
- Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B

- Operatori Ekonomik të ketë Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL. Kodi 1.2.A
- Operatori ekonomik të ketë licencë për Veprimtaritë e Ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditimi mjedisor ndikim në mjedis) Kodi III.2.A(1+2)

2.3.4 Operoret Ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik me licencë të punësuar të vertetuar me kontratë pune më kohë të plotë të figurojë në listepagesat e shoqerisë 6 (gjashtë) muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës)

- Inxhinier ndërtimi 1(një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me kohë të plotë 1 (një) Agronom.

Për këtë duhet të paraqesë Diplomë ,CV, kontratë pune të vlefshme, të figurojë në listepagesat e shoqerisë 6 (gjashtë) muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).

Operatori Ekonomik ploteson formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,(Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni për inxhinieret e sipërcituar paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik)

*Për operoret e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike , Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë stafin mbështetës të punësuar të vertetuar me kontratë pune me kohë të plotë të përfshirë në listepagesat.

- Teknik ndërtimi 1(një) për këtë duhet të paraqesë Diplome të shkolles së mesme , kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Betonueses 2 (dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Pllakashtrues 2 (dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Hekurkthyes 2 (dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit(duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Murator 2 (dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit(duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Elektracist 4 (kater) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre)muajt e fundit (duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).
- Manovrator 2 (dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme , leje manovrimi (Deshmio e aftësisë profesionale) dhe të figurojë në listepagesat e shoqerisë 3 (tre) muajt e fundit(duke marrë në referencë datën e hapjes së procedurës).



- Punetor te thjeshte 5 (pese) per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne liztepagesat e shoqerise 3 (tre)muajt e fundit (duke marre ne reference daten e hapjes se procedures).
- Kopshtar 2 (dy) per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne liztepagesat e shoqerise 3 (tre)muajt e fundit (duke marre ne reference daten e hapjes se procedures).

2.3.6 Një punesim mesatar i te pakten **30 (tridhjete) personave**, punonjes te siguruar. Vertetim te leshuar nga administrate Tatimore , ku te specifikohet numuri i punonjesve dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise 3 (tre) muajt e fundit (duke marre ne reference daten e hapjes se procedures).

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

- 1 (nje) specialist per sigurimin ne pune dhe shendetin ne pune” te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose nga Organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise , kerkese kjo ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M Nr. 312. Date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier”.
- 1 (nje) specialist ekspert zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, bazuar ne piken 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”.

Per specialistin e sigurimit teknik te te paraqitet: Kontrate pune dhe certifikata e trajnimit e leshuar nga institucionet perkatese te akredituara sipas Ligjit Nr 8734 date 01.02.2001 te ndryshuar.

Eksperti Zjarrefikes te disponoje kontrate pune dhe certificate te leshuar nga Drejtoria e MZSH ose organizmat e vleresimit te konformitetit qe jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akredituese te njohur nga Republika e Shqiperise.

2.3.8 Operatori ekonomik ne zbatim te VKM Nr 108 date 09.02.2011 “Per aftesite qe duhet te plotesojne punemarresit, personat dhe sherbimet e specializuara, qemerren me ceshtjet e sigurise dhe shendetit ne pune” ndryshuar me VKM Nr. 632 date 15.07.2015, duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise ose mjek te kontraktuar mga jashte me kontrate sherbimi/me subjekt te specializuar per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licence profesionale nga Ministria e Shendetit. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik , secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kete kerkese duke patur ne konsiderate dhe parashikimet e ligjit te cituara me larte.

### 2.3.9 Çertifikatat qe duhet te paraqesin Operatoret Ekonomik.

- Operatori Ekonomik duhet te paraqese certificate ISO 9001-2015 “ Per menaxhimin e cilesise”,objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Operatori Ekonomik duhet te paraqese certificate ISO 14001-2015 “ Per menaxhim mjedisi”,objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Operatori Ekonomik duhet te paraqese certificate ISO 45001-2018 “Per sistemin emenaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune”,objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqip. Keto certifikata te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit I akredituar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Akreditimit ose nga organizata nderkombetare akredituese te njohura nga Republika e Shqiperise . Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet te plotesoj formularin Per disponimin e mjeteve /pajisjeve/makinerive te nevojshme per realizimin e punimeve objekt kontrate, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik , qe nevojitet per ekzekutimin e kontrates (sipas formularit perkates)

	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<b>1</b>	Kamion me vinc	1	Pronësi ose me qera
<b>2</b>	Kamion me kapacitet mbajtës deri.5 ton	1	Pronësi ose me qera
<b>3</b>	Kamion me kapacitet mbajtës deri.3.5 ton	1	Pronësi ose me qera
<b>4</b>	Minieskavator	1	Pronësi ose me qera
<b>5</b>	Eskavator	2	Pronësi ose me qera
<b>6</b>	Fadrome	1	Pronësi ose me qera
<b>7</b>	Autobetonier	1	Pronësi ose me qera
<b>8</b>	Matrapik	3	Pronësi ose me qera
<b>9</b>	Kompresor	1	Pronësi ose me qera
<b>10</b>	Tranxhë/elektrobango	1	Pronësi ose me qera
<b>11</b>	Saldatrice	3	Pronësi ose me qera
<b>12</b>	Gjenerator 100 këa	1	Pronësi ose me qera
<b>13</b>	Depozitë uji 5000 litra	1	Pronësi ose me qera
<b>14</b>	Motobetoniere	3	Pronësi ose me qera
<b>15</b>	Makineri vijëzimi	1	Pronësi ose me qera
<b>16</b>	Vinc karel	1	Pronësi ose me qera
<b>17</b>	Skeleri	2000 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
<b>18</b>	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	1	Pronësi ose me qera
<b>19</b>	Matës energjie 3 fazor dhe panel te vecante, per llogaritjen nenvecanti te konsumit te energjise nga subjekti ndertues	1	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve , personelit si me poshte:

- Kokore minimumi 30 (tridhjete) cope
- Jeleke minimumi 30 (tridhjete) cope
- Fiksa zjarri te levizeshme minimumi 10 (dhjete) cope
- Prozhektore ndricimi naten minimumi 5 (pese) cope
- Komplet I ndihmes se shpejte minimumi 5 (pese) cope
- Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 20 (njezet) cope
- Karroca dore minimumi 10 (dhjete) cope

a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publik duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe

- siguracionin e mjetit , dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, si dhe lejen e transportit nga institucionet perkatese **(Para lidhjes se kontrates operatori fitues duhet te dorezoj dokumentacionin qe verteton disponimin e mjeteve)**
- b) Per automjete/mjete qe nuk shenohen ne regjistra publik,duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton pronesine e tyre **(Para lidhjes se kontrates operatori fitues duhet te dorezoj dokumentacionin qe verteton disponimin e mjeteve)**
- c) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet dhe pajisjet teknike.

### 2.3.11 Per pajisjet elektrike te cilat do te vendosen ne objekt:

Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizimin ose Kontraten nga prodhuesi/Distributori I autorizuar me te cilin prodhuesi / distributor I autorizuar , autorizon kompanine pjesemarrese ne tender te ofertoje kete pajisje ne kete procedure prokurimi. Per rastin kur autorizimi do te jete leshuar nga distributor I autorizuar , duhet te shoqerohet dhe me: Kontrate partneriteti qe verteton lidhjen e prodhuesit me distributorin .

Autorizimi ose kontrata te shoqerohet me :

- Certificate ISO 9001-2015 “ Per Sistemin e menaxhimit të cilesisë të prodhuesit ose distributorit te autorizuar.

Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet njëvlefshmëria/barazvlefshmëria ose ekuivalent.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 8.***(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË****Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik****(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li> </ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]

përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [ ] Jo [ ]
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :  a) çmimet;	Po [ ] Jo [ ]



<p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	Po [ ] Jo [ ]
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	Po [ ] Jo [ ]

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

<p>Deklarata</p>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</li> </ul> <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</p> <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në</p>

rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [ ] Jo [ ]

#### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

##### A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
--	----------------------

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Deklarata	Përgjigje
